REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KRYETARI

Nr. 4944 Prot. Ballsh më, 21.09.2026

PROJEKT-VENDIM

Nr. 38, datë 21/09/2026

PËR

PËR MIRATIMIN E SHITJES ME ANKAND PUBLIK TË MASËS DRUSORE TË DËMTUAR NGA ZJARRI NË EKONOMINË PYJORE "GADUROVË"

Në mbështetje të nenit 9, pika 1.2, nenit 27, pika 5, neni 54, gërma e, neni 18, pika 2 e Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit nr. 57/2020 "Për pyjet", VKM-së nr. 433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave, sipas listës së inventarëve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive", i ndryshuar, VKM nr. 559, datë 29.07.2022, "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore" si dhe Urdhrit të Ministrit nr. 348, datë 25.06.2026, si dhe dokumentacionit teknik të miratuar,

PROPOZOJ

1. Miratimin e shitjes me ankand publik, në këmbë, të masës drusore të dëmtuar nga zjarri gjatë vitit 2024 në Ekonominë Pyjore "Gadurovë", ngastrat nr. 21, 22/a dhe 23, me sasi totale 5,839 m^3.

2. Miratimin e vlerës bazë të ankandit në masën 500 lekë/m^3, sipas vlerësimit të specialistëve, për një vlerë të përgjithshme prej 2,919,500 lekë.

3. Shfrytëzimi i masës drusore do të realizohet në përputhje me projektin teknik të miratuar, duke respektuar kërkesat teknike, mjedisore dhe të sigurisë në punë.

Konceptoi
Ledian Shehaj

KRYETAR
Qerim Ismailaj

REPUBLIKA E SHQIPERISE BASHKIA MALLAKASTER

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr. 3464
Dt. 03/07/2026

MINISTRIA E MJEDISIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MJEDISIT
DREJTORIA E BIODIVERSITETIT

Nr. 23521/3 Prot. Tiranë, më: 25.6, 2026

Lënda: Dërgim urdhëri, për miratimin e mundësisë vjetore të shfrytëzimit nga prerjet rigjeneruese, për vitin pyjor 2026-2027, për pyjet në pronësi publike, Bashkia Mallakastër

BASHKISË MALLAKASTËR
Lagjia "18 Prilli", Ballsh

Bashkëlidhur gjeni, Urdhrin e Ministrit të Mjedisit, nr.348, datë 25.6.2026 "Për miratimin e mundësisë vjetore të shfrytëzimit, nga prerjet rigjeneruese, për vitin pyjor 2026-2027, për pyjet në pronësi publike, Bashkia Mallakastër".

Me qëllim sigurimin e administrimit dhe menaxhimit të qëndrueshëm, të fondit pyjor e kullosor në pronësinë tuaj, ju sjellim në vëmendje parashikimet ligjore për bashkëpunimin me organet përgjegjëse të ngarkuara me ligj për monitorimin, kontrollin dhe inspektimin.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Ledina BEQIRAJ AGALLIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E MJEDISIT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E MJEDISIT

MINISTRI

Nr. 2852/2 prot. Datë 25.6.2026

URDHËR

Nr. 348, datë 25.6.2026

"PËR MIRATIMIN E MUNDËSISË VJETORE TË SHFRYTËZIMIT NGA PRERJET RIGJENERUESE, PËR VITIN PYJOR 2026-2027, PËR PYJET NË PRONËSI PUBLIKE, BASHKIA MALLAKASTËR"

Në mbështetje të shkronjës "dh" të nenit 59, pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, pikës 2, neni 27, të ligjit nr.57/2020, datë 30.4.2020, "Për pyjet", i ndryshuar, dhe shkresën e bashkisë Mallakastër nr.2330/1 Prot., datë 19.05.2026 "Kërkesë për miratimin e shfrytëzimit për dru zjarri të ekonomisë pyjore "Gadurovë", djegur gjatë vitit 2024",

URDHËROJ:

1. Miratimin e mundësisë vjetore të shfrytëzimit nga prerjet rigjeneruese, për vitin pyjor 2026-2027, të pyjeve në pronësi publike, Bashkia Mallakastër. Ndërhyrjet kryhen nëpërmjet prerjeve rigjeneruese e shëndetësore, sipas projekteve teknike të miratuara në ngastrat e nënngastrat 20, 22/a dhe 23, Ekonomia Pyjore "Gadurovë".

2. Sasia që pritet të jetë 5839 m^3, dru zjarri, e llojeve pishë mesdhetare.

3. Të realizohet ripyllëzimi me farë/fidanë i sipërfaqeve të djegura në ngastrën 20, dhe nënngastrat 22/a dhe 23, Ekonomia Pyjore "Gadurovë".

4. Gjatë gjithë proçesit të hartimit të dokumentacionit, proçesit dhe kryerjes së ndërhyrjeve duhen zbatuar parashikimet në VKM nr.614, datë 23.10.2025 "Për miratimin e rregullave për trajtimin, shfrytëzimin, shitjen, eksportin, importin, administrimin dhe transportin e materialit drusor e të prodhimeve jodrusore pyjore, si dhe kategorizimin e rrugëve autopyjore, përdorimin dhe standardet teknike të tyre" dhe VKM nr.297, datë 17.5.2023 "Për miratimin e proçedurave për kryerjen e veprimtarive të shfrytëzimit në Fondin Pyjor Kombëtar nga individë apo subjekte të liçensuara".

5. Gjatë ndërhyrjeve në ngastrat e caktuara për vjeljen e materialit drusor, nuk do të pritet apo dëmtohen drurët e llojeve panjë dhe asnjë nga llojet e listës së kuqe, të përcaktuara në VKM-ve nr.804, datë 04.12.2003, "Për miratimin e listës së specieve të florës shqiptare që vihen në mbrojtje".

6. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet Bashkia Mallakastër, strukturat përgjegjëse kontrolluese/inspektuese në bashki si dhe Agjencia Kombëtare të Pyjeve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

SOFJAN JAUPAJ

PROTOKOLLI
Nr. 2330/2
11/08/2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PYJEVE
DREJTORIA E ANALIZËS DHE PERFORMANCËS

Nr. 582/1 prot.

Tiranë, më 09.08.2026

Lënda: Kthim përgjigjeje për miratimin e shfrytëzimit për dru zjarri të projektit teknik "Për Vlerësimin e masës drusore në ngastrat e djegura në Ekonomin Pyjore "Gadurovë", Mallakastër në vitin 2024

BASHKISË MALLAKASTËR
DREJTORISË SË PYJEVE DHE MJEDISIT
SEKTORI I MENAXHIMIT TË PYJEVE DHE MJEDISIT
Adresa; Lagjja, 18 Prrilli Ballsh. ***Mallakastër***

Për dijeni:

MINISTRISË SË MJEDISIT
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME PËR ZHVILLIMIN E MJEDISIT
DREJTORISË SË NATYRËS DHE PYJEVE
Bulevardi: "Dëshmorët e Kombit", Nr. 1, 1001, Tiranë

Në përgjigje të shkresës suaj nr. 2330/1 Prot., datë 19.05.2026, për miratimin e shfrytëzimit për dru zjarri të projektit teknik "Për Vlerësimin e masës drusore në ngastrat e djegura në Ekonomin Pyjore "Gadurovë", ngastrat 21,22/a,23 të djegura nga zjarri i rënë në vitin 2024, protokolluar pranë Agjencisë Kombëtare të Pyjeve me nr. 582 Prot., datë 22.05.2026, ju informojmë sa vijon: Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga Sektori i Menaxhimit të Pyjeve dhe Mjedisit, Bashkia Mallakastër, u konstatua se:

1. Modeli i projekteve teknologjik i ndërhyrjeve është i hartuar sipas aneksit nr. 2, që i është bashkëlidhur Vendimit nr. 614, datë 20.10.2025 në neni 3 pika 7 sigurimi i druve të zjarrit për ngrohje nga banorët e fshatrave në zonat malore dhe në brëndëi, kryet sipas projekteve të hartuara nga struktura përgjegjëse për pyjet në bashki.

2. Dokumentacioni i paraqitur plotëson kushtet teknike ligjore për të ndërhyrë për të realizuar vjelejet e matreialit drusor për vitin 2026-2027".

Mbështetur në ligjin nr. 57/2020, datë 30.04.2020 "Për Pyjet", Neni 32 pika 2; dhe Vendimit nr. 614, datë 20.10.2025 **miratojmë** ndërhyrjet e parashikuara në planet e mbarështrimit për vitin 2026-2027".

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

DREJTORI I PËRGJITHSHËM
Rudina Hoxha

